

**AKTI I THEMELIMIT**  
**DHE STATUTI I**  
**SHOOËRISE**  
**“NETWISE AL” SHPK**

**THEMELIMI**

**Neni 1**

**Ortaku themelues**

1.1 Shoqëria “NETWISE AL” SH.P.K. themelohet nga Ortaku:

**Znj. Enika Hajdari**, shtetase shqiptar, lindur më 09.10.1985 ne Tirane, Shqiperi, rezidente ne Tirane, mbajtese e Pasaportes me nr. BD0533896 dhe nr. Personale I56009054W me zotesi te plete per te vepruar,

**EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE**

**Neni 2**

**Emërtimi**

2.1 Emërtimi i shoqërisë është “NETWISE AL” SH.P.K.

**Neni 3**

**Forma ligjore**

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjisacionin tregtar në Shqipëri.  
3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjeter në përputhje me legjisacionin shqiptar.

**Neni 4**

**Baza ligjore**

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjisacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

**Neni 5**

**Kohëzgjatja e veprimtarisë**

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qëndrën Kombëtare të Biznesit (“QKB”).  
5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pacaktuar.

**Neni 6**

**Selia**

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rr. Besim Alla, Pallati. Alfa, Hyrja 4, Dyqani nr.14, Njesia Administrative nr.14, Tirane  
6.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësimi si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.  
6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

**Neni 7**

### **Emblema. Vula**

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemën dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjisacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përbajnë emblemën dhe vulën e saj.

### **Neni 8**

#### **Objekti**

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:
- Sherbime te menaxhimit te Teknologjive kompjuterike
  - Disenjimi i infrastruktures se Teknologjive kompjuterike
  - Sherbime te mbrojtjes kompjuterike, mbrojtje ndaj cyber security, back up, mbrojtje end point, mbrojtje te te dhenave
  - konsulencë dhe ndihmë për çështjet e menaxhimit të projektit në lidhje me riorganizimin dhe kompjuterizimin e proceseve të biznesit;
  - konsulencë dhe ndihmë në operacionet e zbatimit të aplikimit;
  - trajnimi i punonjësve për metodologjitet e proceset që lidhen me teknologjinë e informacionit;
  - Sherbime te studimit dhe monitorimit per te trete te produktivitetit dhe performances
- 8.2 Objekti i shoqerise mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

### **Neni 9**

#### **Kapitali**

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 Leke.
- 9.2 Kapitali ndahet në 1 (nje) pjesë.
- 9.3 Pjesa e kapitalit zotërohet 100% nga Ortaku i vetem.
- 9.4 Kapitali është shlyer tërësisht.

### **Neni 10**

#### **Transferimi i pjesëve të kapitalit. Kufizimet.**

- 10.1 Pjesët e kapitalit mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet perkatese.
- 10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblese se Pergjithshme.

### **Neni 11**

#### **Rritja e kapitalit**

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblese se Pergjithshme.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

### **Neni 12**

### **Zvogëlimi i kapitalit**

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.
- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Asambleja e Pergjithshme e shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblese se Pergjithshme raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.
- 12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Asamblese se Pergjithshme të shoqërisë.

## **ORGANET E SHOQËRISË**

### **Neni 13 Organë Vendimarres**

- 13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise.
- 13.2 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme përfshijnë kryesisht:
- Ndryshimet e statutit
  - Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
  - Emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
  - Percaktimin e shperblimeve te administratorit/Administratoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
  - Ndryshimin e selisë ose të emërtimit të shoqërisë;
  - Rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
  - Shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
  - Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
  - Miratimin e bilancit të shoqërisë;
  - Transformimin e shoqërisë në formë të tjera.

### **Neni 14 Administrimi**

- 14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Asamblese se Pergjithshme.
- 14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Asamblese se Pergjithshme.
- 14.3 Administratore te shoqërisë eshte:  
Znj. Enika Hajdari, shtetase shqiptar, lindur më 09.10.1985 ne Tirane, Shqiperi, rezidente ne Tirane, mbajtese e Pasaportes me nr. BD0533896 dhe nr. Personale I56009054W me zotesi te plote per te vepruar
- 14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
  - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëni me të tretë personalisht ose me përfaqësim;
  - Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
  - Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;
  - Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe

realizimin e objektit të saj.

- Administratori ka të drejtë për ta përfaqësuar shoqërinë në Shqipëri tek palët e treta, insitucionet apo entitetet publike ose private;
- Të lidhë, për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
- Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e biznesit;
- Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;
- Të ndërmarrë çdo veprimtari tjetër ose biznes ose aktivitet, te hape dege ose zyre perfaqësimi, që konsiderohen te nevojshëm për biznesin e shoqërisë.

14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për pesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

### **Neni 15 Viti financiar**

15.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.

15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

### **Neni 16 Bilanci. Kontabiliteti.**

16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Pergjithshme dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatumore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkësave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me illogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.

16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

### **Neni 17 Te Ardhurat. Dividendi**

17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkësat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport më pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë.

17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të pergjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

### **Neni 18**

### **Likuidimi**

- 18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Asamblese se Pergjithshme.
- 18.2 Me vendimin e Asamblese se Pergjithshme caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, Asambleja e Pergjithshme do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likuidimit.

### **Neni 19**

#### **Mosmarrëveshjet**

- 19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Tiranë, datë 25.02.2022

ORTAKU:

Znj. Enika Hajdari

